

Enver Foniqi (kryetar)  
Mobil: 076 558 82 29  
E-mail: [enver.foniqi@17shkurti.ch](mailto:enver.foniqi@17shkurti.ch)  
[enverfoniqi@hotmail.com](mailto:enverfoniqi@hotmail.com)

Datë: 29.Janar 2012

## **Raporti i kryetarit në kuvendin e 6-të të përgjithshëm të shoqatës „17shkurti.ch**

Zonja dhe zotërinjë, anëtarë të nderuar të shoqatës sonë

Nga 06. Marsi 2011, kam pasur nderin që për një vit të jem kryetar dhe pjesë e një shoqate (organizate) të tillë, e cila për 3 vjet me radhë ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuoj për të mirën e fshatit dhe bashkëfshatarëve tanë.

Nuk ka qenë **ngarkese** dhe **obligim** shumë i madh, por më shumë privilegj dhe krenari.

**Krenari** kur sheh që numri i anëtarëve të shoqatës nga dita në ditë shtohet, ashtu si shtohet realizimi projekteve tona në fshat.

**Kënaqësi shpirtërore** kur sheh që me një angazhim dhe kontribut të vogël, i kthehet fëmijëve **buzëqeshja** e ngrirë në fytyrë dhe shpresa për një të ardhme më të mirë.

Kënaqësi kur sheh që me **kontributin** tonë motivohen **nxënësit** për të arritur olimpet më të larta të dijes, interesimin e të rinjëve për aktivitete të ndryshme sportive dhe aktivizimin e tërë fshatit rreth shoqatës sonë.

### **KRYESIA**

Kryesisht jam i kënaqur me anëtarët e kryesisë dhe i faleminderoj ata për kontributin e tyre. Kuptohet që ka pasur mungesa të arsyshme dhe të paarsyeshme, por me rëndësi është që gjatë marrjes së vendimeve, kryesia gjithmonë ka gjetur një koncenzus dhe një gjuhë të përbashkët. Kam vetëm një lutje për gjithë anëtarët e ardhshëm që hynë në kryesi, që të punojnë sinqerisht dhe të marrin angazhimin e tyre në kryesi si obligim moral ndaj shoqatës dhe ndaj kryesisë (bashkëkolegëve).

### **MBLEDHJET E KRYESISE**

Gjithsejt gjatë këtij mandati, kjo kryesi i ka mbajtur „**vetëm**“ **15** mbledhje, ca maratonike e ca syresh më të shkurtëra.

Karakteristikë ka qenë se asnjë mbledhje nuk ka qenë e kompletuar kryesia. Në cdo mbledhje ka munguar ndonjë anëtar, kush shumë shpesh e kush vetëm një apo dy herë.

Poashtu vlen të theksohet se gjatë organizimit dhe realizimit të „JAVES KULTURORE – MIRESHI 2011“ kryesia është takuar cdo ditë me qëllim të mbarëvajtjes sa më të mirë të këtij organizimi

Me c’rast dua t’i faleminderoj gjithë ata anëtarë jo vetëm të kryesisë (sepse dikush nga ata nuk ka kontribuar pothuajse hiq për këtë manifestim), por edhe disa anëtarë të shoqatës të cilët na kanë përkrahur dhe ndihmuar në cdo rast dhe situatë.

## **ANETARESIA**

Edhe këtë vit numri i anëtarëve ka shënuar rritje, por duhet theksuar se poashtu ka raste kur anëtarët e deritanishëm, për arsye që vetëm ata i dinë, nuk e kanë kryer obligimin ndaj shoqatës për vitin 2011.

Poashtu një karakteristikë e këtij viti ka qenë edhe interesimi i personave nga jashtë Doberqani për të paguar anëtarësinë.

Numri rendor ka arritur deri në 180. Ndërsa numri i anëtarëve të rinjë për këtë vit është rreth 40 sosh.

Kemi anëtarë nga Gjermania, Belgjika, Suedia, Amerika si dhe disa lokalë nga Kosova(Doberqani).

## **PROJEKTET E REALIZUARA**

Gjatë këtij mandati janë realizuar mbi 30 projekte të ndryshme.

1. Vitin 2011 kemi finalizuar projektin për të ndihmuar shkollën e futbollit KF „STUDENTI“ me gjitha pajisjet e nevojshme.
2. Manifestimi për nderë të 3 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës dhe 2 vjetorit të themelimit të shoqatës „17shkurti.ch“
3. Poashtu në emër të shoqatës kemi marr pjesë edhe në një turnir në futboll të vogël „MALESIA CUP 2011“
4. Është vazhduar me projektin „Mirëmbajtja e fshatit (rrugëve)“ nga Isa Foniqi
5. Ndihmë familjeve nevojtare në fshat (2 herë)
6. Mbrojtset (hekurat) e urave në fshat
7. Ndriçimi (reflektorët) i fushës sportive pranë oborrit të shkollës fillore

8. Finalizimi i projektit të shtëpisë së djalit të dëshmorit, Mulla Nysret Hajdarit, i nisur qysh në vitin 2010.
9. Tabëll (kapak) mbrojtës për trafon kryesore te parku.
10. Vendosja e shportave të reja të hedhurinave në park.
11. Renovimi i urës së mullirit
12. Rregullimi i bankave (ulëseve) të parkut
13. „Java kulturore Mireshi 2011“ e cila ka qenë shumë e pasur me aktivitet të ndryshme kulturore dhe sportive
14. Shpërblimi i nxënësve më të dalluar në kuadër të shkollës së fshatit.
15. Iftarë për bashkëfshatarët tanë  
Në kuadër të këtij projekti, kemi inicuar një aksion publik në të cilin kanë mundur të kontribuojnë secili person që ka shprehur dëshirë për t’u realizuar disa iftare në fsjat.
16. Ndihmë plotësuese (kontigjenti i dytë) për shkollë e futbollit KF „STUDENTI“
17. Një vitrinë (dollar) në kuadër të shkollës për kabinetin e biologjise dhe kimisë.
18. Participimi në instalimin e nxemjes qendrore te xhamia e epërme
19. Ndihmë për Kurban-Bajram (një lopë në formë Kurbani për bashkëfshatarët tanë.
20. Dollar (magacinë) në shtëpinë e kulturës për të ruajtur veglat dhe veshjet kombëtare.
21. Web-kamerat në fshat. Kryesia ka parë të arsyeshme që të vendosen 2 kamera ne fshat.  
Në 10 ditëshin e fundit të Nëntorit kemi pasur fazën testuese të pamjeve live nga fshati ynë.
22. Manifestimi për nderë të „28 Nëntorit“
23. Konkursi dhe vendimi për angazhimin e një punëtori i cili do të mirëmbaj shtratin e lumit.

## **E ARDHMJA**

Do të doja që shoqata „17shkurti.ch“ të jetë edhe më masovike, e bashkuar nën flamurin e devotshmërisë dhe sinqeritetit dhe e frymëzuar nga humanizmi dhe atdhedashuria.